



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1602 Prot.

Tiranë, më 19 / 11 / 2020

V E N D I M

Nr. 172, Datë 19 / 11 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.86 regj., datë 30.07.2020¹ të B. C, kundër Ministrit të Drejtësisë dhe ish-Kryeregjistruesit të ish-Zyrës së Përgjithshme të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme /ish- ZQRPP², me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjinisë³”, “përkatësisë në një grup të veçantë⁴” dhe “çdo shkak tjetër⁵”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, B. C, ka mbajtur detyrën e Regjistrueses pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Berat, emëruar nga Ministri i Drejtësisë, për një periudhë 10 mujore, nga data 03.05.2018 deri më datë 13.03.2019.

Nëpërmjet Urdhrit nr.5029/2, datë 03.05.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, ankuesja është emëruar në mënyrë të përkohshme në këtë detyrë, deri në

¹ Sjellë me e-mail me datë 06.03.2020, plotësuar dokumentacioni me datë 28.07.2020 (me e-mail) dhe regjistruar pranë KMD me datë 30.07.2020.

² Sot me emërtimin Agjencia Shtetërore e Kadastrës/ ASHK)

³ Krahason veten me punonjës in që e ka zëvendësuar atë.

⁴ Referimet tek ky shkak ankuesja i ka shpjeguar me faktin se e konsideron veten si pjesë të grupit të punonjësve që nuk zbaton urdhrat e kundraligjshëm të eprorit” .

⁵ Me “çdo shkak tjetër” ankuesja shpjegon konfliktin e krijuar mes saj dhe eprorit direkt, ish-Kryeregjistruesit të ish-ZQRPP.

⁶ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

përfundim të procedurave ligjore të plotësimit të pozicionit të Regjistruesit përmes procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi. Kjo marrëdhënie pune nuk rezulton të jetë formalizuar nëpërmjet kontratës së punës.

Nëpërmjet Urdhrit nr.201, datë 13.03.2019 “Për lirim nga detyra”, Ministri i Drejtësisë ka urdhëruar lirimin e ankueses nga detyra, me motivacionin e mospërbushjes së detyrës dhe shkeljes së rregullave të etikës, duke referuar në përmbajtjen e tij, si shkak të largimit të saj nga detyra, propozimin e ish-Kryeregjistruesit, të bërë me shkresën me nr.2132 prot., datë 07.03.2019, me lëndë: “Relacion për veprimet e Regjistrueses së ZVRPP Berat”.

Referuar përmbajtjes së këtij relacioni, ish-Kryeregjistruesi ka parashtuar si vijon: “Nga Regjistruesja e ZVRPP Berat, në mënyrë të përsëritur nuk janë zbatuar orientimet e dhëna nga ZQRPP me shkresat me nr.125/5 prot., datë 21.06.2018 dhe nr.6432/3 prot., datë 25.09.2018, duke mos kryer pasqyrim të saktë të të dhënave të regjistrimit për të garantuar saktësinë e informacionit, në lidhje me ankesën e subjektit “Stela” sh.p.k, edhe pse nga ZQRPP janë trajtuar me seriozitet të gjitha çështjet ligjore përsëri nga ana e Regjistrueses së ZVRPP Berat nuk veprohet duke mos sjellë asnjë argument ligjor. Nga verifikimi i aplikimeve në IPS është konstatuar se ZVRPP Berat nuk ka zbatuar me rigorizitet Urdhrin e Kryeregjistruesit me nr.1727, datë 04.12.2018, pasi një numër aplikimesh të cilat duhet të kryhen branda 48 orëve janë përfunduar jashtë afatit. Gjithashtu, me datë 27.02.2019 Zëvendëskryeministri, në përmbushje të funksioneve të veta, ka zhvilluar një vizitë pune në qytetin e Beratit për të monitoruar cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike ndaj qytetarit, ka ushtruar verifikim pranë ZVRPP Berat dhe nga konstatimet ka rezultuar se Regjistruesja B. C nuk ka qenë në punë ë fillimin e orarit zyrtar si dhe organizimi i punës dhe personelit nuk ishte në nivelet e kërkuara për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për qytetarët e Beratit, duke i konsideruar këto veprime si shkelje të detyrës dhe etikës profesionale”.

Nga përmbajtja e shkresës me nr.125/5 prot., datë 21.06.2018, e administruar në dosje, rezulton se për subjektin në fjalë “Stela” sh.p.k, ka patur një urdhër refuzimi, konkretisht Urdhri nr.444, datë 25.05.2009, pra, gati 10 vite para se ankuesja të emërohej në detyrën e Regjistrueses së ZVRPP Berat. Nëpërmjet kësaj shkrese, vetë ish-ZQRPP, ndër të tjera, ka urdhëruar ZVRPP Berat ta rishikojë Urdhrin, duke e orientuar atë të rishqyrtojë edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kërkues “Stela” sh.p.k, duke kryer procedurat përkatëse për zgjidhjen e problemit, dhe pasi të vendosë të njoftojë, subjektin dhe Zyrën Qendrore.

ZVRPP Berat, pas shqyrtimit të dosjes së subjektit “Stela” sh.p.k ka informuar ish-ZQRPP, ndër të tjera se: “Nga ZVRPP Berat është argumentuar se subjekti “Stela” sh.p.k është në një proces gjyqësor dhe për këtë fakt nuk mund të trajtohet aplikimi i tij për pajisje me dokument pronësie. Nga ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është ngritur kërkesë padi lidhur me shqyrtimin e kësaj çështjeje”.

Ankuesja shprehet se qëndrimi i ZVRPP Berat lidhur me trajtimin e kësaj çështjeje është i drejtë dhe tërësisht ligjor, fakt i mbështetur ky edhe nga verifikimi i bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili, pas verifikimit të ankesës së bërë nga subjekti “Stela” sh.p.k lidhur me praktikën e ndjekur

nga ZVRPP Berat, nëpërmjet shkresës me nr.165/2 prot., datë 18.04.2017 i ka rekomanduar subjektit të ndjekë rrugën gjyqësore dhe nuk ka evidentuar asnjë shkelje nga ana e ZVRPP Berat. Po ashtu, dhe Ministria e Drejtësisë, lidhur me këtë rast ka shprehur qëndrimin e vet se: *“ZVRPP Berat duhet të vijojë me trajtimin e kërkesës për regjistrim të subjektit “Stela” sh.p.k vetëm në rast aplikimi dhe depozitimi të dokumentacionit shtesë nga subjekti i interesuar dhe të ndjekë procesin gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat si palë e tretë, deri sa vendimi të marrë formë të prerë”*.

Ankuesja citon se, bazuar në sa më sipër, si dhe në kushtet kur subjekti “Stela” sh.p.k është në proces gjyqësor dhe ende nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë, ZVRPP Berat e ka njoftuar atë se nuk mund të vijojë procedurat deri sa ai të paraqesë dokumentacion shtesë dhe vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë.

Lidhur me motivacionin e cilësuar në urdhrin e largimit të saj, si mospërbushje të detyrës, ankuesja ka evidentuar se për periudhën janar-mars 2019, nga ZVRPP Berat janë administruar 878 praktika, nga të cilat, me vonesë janë gjithsej 46; nga të cilat 12 janë me 1 ditë vonesë, disa me 2-3 ditë dhe gati 20-25 prej tyre janë me vonesë të konsiderueshme. Ajo ka argumentuar se, referuar shifrave të mësipërme, si dhe nisur nga një volum i tillë pune, nuk mund të pretendohet se ka mospërbushje të detyrës.

Subjekti ankues citon se, para daljes së urdhrin për largimin e saj, në datë 04.03.2019 pranë Kryeministrisë është zhvilluar takimi mujor i radhës që regjistruerit dhe drejtorët e ALUIZNI-t kryejnë me Kryeministrin dhe gjatë këtij takimi, vetë Zëvendëskryeministri kishte relatuar se nga ana e ZVRPP Berat, për muajin shkurt 2019 janë realizuar detyrat në masën 103%. Menjëherë pas këtij relatimi, Zëvendëskryeministri kishte kërkuar dorëheqjen e saj, pasi nuk kishte mbetur i kënaqur nga performance e stafit, gjatë kontrollit të befasishëm të tij më datë 26.02.2019.

Lidhur me sa më sipër, ankuesja është shprehur se, gjatë 10 muajve që ajo ka ushtruar detyrën e Regjistruerit të ZVRPP Berat, ishin bërë kontrole të herëpashershme nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Kontrolli Tekniko-Ligjor i ish-ZQRPP, kontrolli i Task Forcës, i Ministrisë së Drejtësisë e ish-ZQRPP dhe asnjë prej tyre nuk ka konstatuar asnjë shkelje apo mosrealizim të detyrave nga ana e saj. Shkaku i vërtetë sipas saj ka të bëjë me e-mailin e mëposhtëm dërguar nga Zëvendëskryeministri, pa asnjë provë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë.

Ankuesja ka depozituar e-mailin e dërguar në drejtim të saj nga Zyra e Zëvendëskryeministrit më datë 27.02.2019, në përmbajtje të të cilit citohet: *“Ju bëjmë me dije se, më datë 27.02.2019, Zëvendëskryeministri, në përmbushje të funksioneve të veta, ka zhvilluar një vizitë pune në qytetin e Beratit për të monitoruar cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike ndaj qytetarit. Në orën 08:14 min, në asnjë nga 6 sportelet e ZVRPP Berat nuk kishte punonjës prezent. Në orën 08:44 min u hap një nga 6 sportelet prej një punonjëseje të Zyrës, e cila ishte me një veshje tërësisht të papërshtatshme, komunikimi aspak profesional dhe toni i papërshtatshëm ndaj qytetarit të moshuar duke mos i ofruar shërbim nën pretekstin se nuk punonte sistemi, ndërkohë që sipas konfirmimit tuaj ky fakt është i pavërtetë. Vetëm në orën 09:00 u shfaqën 3 nëpunës në sportele, nga 6 të tillë. Zëvendëskryeministri kërkoi të takohej me Regjistruerit por u njoftua se nuk ndodhej në Institucion, pavarësisht se ora shënonte 09:00”*.

Lidhur me motivacionin për shkelje të etikës, znj.C pretendoi se nuk ka patur asnjë akt që të përcaktonte detyrimin e punonjësve të ZVRPP Berat që të vishnin uniformë dhe vetëm pas vizitës së Zëvendëskryeministrit ka dalë një urdhër i tillë nga ish-Kryeregjistruesi.

Ankuesja po ashtu, ka pretenduar se nuk qëndronte fakti i vonesës në punë apo që sistemi ka funksionuar, pasi në datën 26.02.2019 sistemi nuk ka funksionuar as në ZVRPP Berat dhe në asnjë ZVRPP në Republikën e Shqipërisë, dhe për këtë fakt, IT i Institucionit kishte vënë në dijeni Zyrën Qendrore.

Ankuesja pretendon se motivacioni i shënuar në urdhrin e largimit të saj nga puna është në kundërshtim me ligjin, abuziv dhe diskriminues, dhe shpreh bindjen se arsyeja e vërtetë buron nga fakti që ajo nuk ka zbatuar urdhrat e kundraligjshme të ish-Kryeregjistruesit për regjistrimin e subjektit “Stela” sh.p.k.

Nga aktet bashkëlidhur ankesës, konstatohet se znj.C, çështjen në fjalë e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila është shprehur nëpërmjet Vendimit nr.898, datë 08.10.2019.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga ana e punëdhënësit, Ministria e Drejtësisë dhe dëmshpërblimin si pasojë e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁷, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

⁷Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Duke qenë se ankesa kishte mangësi nga ana formale përsa i takon shpjegimit të shkaqeve, nëpërmjet shkresës me nr.1119/1 prot., datë 11.08.2020, Komisioneri i ka kërkuar ankueses ta plotësojë atë.

Neni 93/1 i Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar ka parashikuar se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.*

Me shkresën me nr.1119/2 prot., datë 19.08.2020 ankuesja ka sjellë shpjegimet e saj lidhur me shkaqet për të cilat pretendon diskriminimin.

2. Nëpërmjet shkresës me nr.119/3 prot., datë 21.08.2020 Komisioneri ka njoftuar subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa: MD⁸ dhe ASHK dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr.5224/1 prot., datë 28.08.2020 MD ka përcjellë pranë KMD, dokumentacionin poshtëcituar, duke mos argumentuar lidhur me sa ka pretenduar subjekti ankues. Kështu MD, ka depozituar në cilësi prove:

- Kopje të shkresës me nr.4058 prot., datë 03.05.2018 të ish-ZQRPP “Propozim për emërim të përkohshëm në detyrë”, kopje të Diplomës së ankueses, CV, Librezës së Punës, Formularit të Vetëdeklarimit, ID.
- Kopje të shkresës me nr.5029/2 prot., datë 03.05.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për emërim të përkohshëm në detyrë”.
- Kopje të shkresës me nr.3387/1 prot., datë 28.05.2018 “Njoftim për dorëheqje nga pozicioni i Regjistruarit të ZVRPP Berat”.
- Kopje të shkresës me nr.4058/4 prot., datë 01.06.2018 të ish-ZQRPP “Propozim për lirim nga detyra të Regjistruarit të ZVRPP Berat”.

⁸ Ministria e Drejtësisë

- Kopje të shkresës me nr.3387/3 prot., datë 26.06.2018 “Kërkesë për revokimin e dorëheqjes”.
- Kopje të shkresës me nr.4058/6prot., datë 05.07.2018 të ish-ZQRPP “Dërgim i shkresës të ZVRPP Berat”.
- Kopje të shkresës me nr.7665/1 prot., datë 09.07.2018 “Në lidhje me kërkesën e B. C”.
- Kopje të shkresës me nr.2132 prot., datë 07.03.2019 të ish-ZQRPP “Relacion për veprimet e Regjistrueses së ZVRPP Berat”.
- Kopje të Urdhrit me nr.201, datë 13.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për lirimin nga detyra”.

Institucioni i ASHK nuk solli asnjë parashtrim apo dokumentacion provues lidhur me sa kishte kërkuar Komisioneri, megjithëse provohet kishte marrë dijeni që me datë 24.08.2020⁹.

3. Nëpërmjet shkresës me nr.1119/1 prot., datë 16.09.2020 Komisioneri dërgoi sërish kujtesë për informacion drejtuar ASHK, lidhur me përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në shkresën me nr.1119/3 prot., datë 21.08.2020.

ASHK, nëpërmjet shkresës me nr.9757/5 prot., datë 05.10.2020 ka informuar Komisionerin, lidhur me momentin e emërimit dhe lirimit nga detyra të ankueses, duke cituar se vendimi i Ministrit të Drejtësisë për lirimin nga detyra të znj.C është bazuar në performancën e saj të ulët në drejtimin e ZVRPP Berat, dhe në asnjë paragjykim të situatës apo diskriminim çfarëdolloj qoftë ai.

Në vijim ASHK thekson se, në rastin e Regjistrueses të Zyrave Vendore, punëdhënësi ka qenë Ministria e Drejtësisë, e cila kujdesej për zhvillimin e procedurave të konkurimit publik për rekrutimin e Regjistrueses të ZVRPP-ve, në të gjitha etapat, nga shpallja e konkurimit deri në emërimin e tyre.

Bashkëlidhur përgjigjes, ASHK nuk ka depozituar pranë KMD dokumentacion provues, me arsyetimin se: *“MD në cilësinë e punëdhënësit ju ka vënë në dispozicion kopje të procedurës së ndjekur për emërimin dhe lirimin e znj.C, duke mos e bërë të nevojshme ridërgimin e të njëjtit informacion nga ana jonë”*, duke lënë të kuptohet se nuk dispononte dokumentacionin dhe informacionin e plotë që ishte kërkuar nga KMD.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të ankueses nga ana e Ministrisë së Drejtësisë (MD), në tagrin e punëdhënësit të saj.

⁹ Referuar kuponit postar të marrjes dijeni, nëpërmjet dorëzimit të shkresës nga shërbimi postar i Postës Shqiptare, i cili ndodhet i depozituar në dosjen personale të subjektit ankesë pranë KMD.

Në kontekst të legjitimitit të ankimimit kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ka pretenduar diskriminimin, *Komisioneri vëren se*, bazuar në:

- Nenin 13, pika e) e ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.
- Nenin 19/2 të po këtij Ligji.
- Urdhrin nr.5029/2 prot., datë 03.05.2018 “Për emërimin të përkohshëm në detyrë” të B. C.
- Urdhrin nr.201, datë 13.03.2019 “Për lirim nga detyra” të B. C;

gëzon legjitimitim pasiv në këtë proces vetëm Ministria e Drejtësisë, pasi ajo gëzon tagrin e punëdhënësit të ankueses.

Për rrjedhojë, ish-ZQRPP/aktualisht ASHK, nuk gëzon legjitimitin pasiv lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për lirim nga detyra, pasi nuk ka tagrin e punëdhënësit të saj.

Në këtë kontekst, shqyrtimi i pretendimit të ankueses, lidhur me trajtimin e padrejtë të saj nga ana e ish-ZQRPP/aktualisht ASHK nuk do të merret në shqyrtim nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative dhe Kodi i Punës, i ndryshuar, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast, MD, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, dhe të paligjshme për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Nëpërmjet Urdhrit nr.5029/2, datë 03.05.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, ankuesja është emëruar në mënyrë të përkohshme në detyrën e Regjistrueses pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Berat, deri në përfundim të procedurave ligjore të plotësimit të pozicionit të Regjistruetit përmes procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi. Kjo marrëdhënie pune nuk rezulton të jetë formalizuar nëpërmjet kontratës së punës.

Nëpërmjet Urdhrit nr.201, datë 13.03.2019 “Për lirim nga detyra”, Ministri i Drejtësisë ka urdhëruar lirimin e ankueses nga detyra, me motivacionin e mospërbushjes së detyrës dhe shkeljes së rregullave të etikës, duke referuar në përmbajtjen e tij, si shkak të largimit të saj nga detyra, propozimin e ish-Kryeregjistruetit, të bërë me shkresën me nr.2132 prot., datë 07.03.2019, me lëndë: “Relacion për veprimet e Regjistrueses së ZVRPP Berat”.

Në analizë të shkaqeve të pretenduara në shkresën sipërcituar, Komisioneri vëren se:

Lidhur me pretendimin për mospërbushje të detyrave dhe shkelje të rregullave të etikës nga ana e ankueses, për shkak të:

- a) Moszbatimit të orientimeve të dhëna nga ish-ZQRPP me shkresën me nr.6432/3 prot., datë 25.09.2018 dhe me nr.125/5 prot., datë 21.06.2018, lidhur me ankesën e subjektit “Stela” sh.p.k;
- b) Moszbatimit me rigorizitet të Urdhrit nr.1727, datë 04.12.2018 të ish-Kryeregjistruetit, për një numër aplikimesh të përfunduara jashtë afatit 48 orësh;
- c) Mungesës në punë të Regjistrueses në fillimin e orarit zyrtar dhe për shkak se organizimi i punës dhe personelit nuk ishte në nivelet e kërkuara për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për qytetarët e Beratit;

Nga analizimi i përmbajtjes së këtij relacioni rezulton se:

Së pari, lidhur me ankesën e subjektit “Stela” sh.p.k, për mosregjistrimin apo vendosjen e kufizimit sipas nenit 59 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nga ana e ZVRPP Berat, Komisioneri vëren se:

- Ish-Kryeregjistrueti është në tejkalim të kompetencës që i jep ligji kur urdhëron ZVRPP Berat të rishqyrtojë dokumentacionin dhe të regjistrojë pronar subjektin “Stela” sh.p.k, me orientimet përkatëse, pasi ligji nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ia njeh këtë diskrecion Regjistrueses së ZVRPP.

Kështu, neni 20 i tij ka përcaktuar se, Regjistrueti ka këto kompetenca:

“Drejton dhe organizon veprimtarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për realizimin e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të saj, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi;

përgjigjet dhe raporton para Kryeregjistruetit dhe Bordit Drejtues për veprimtarinë e zyrës vendore;

t'i lëshojë personit të interesuar, që ka të drejtën të kërkojë, certifikatë pronësie, qiraje apo të interesave të tjerë të regjistruara në kartelë mbi pasurinë e paluajtshme;
të kërkojë me shkrim ose me shkresë zyrtare nga personi i interesuar që, brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditë, të paraqesë dokumentet e pronësisë, certifikatat, çdo dokument tjetër apo plan rivevimi, të lidhur me pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën në fjalë. Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar kërkesa për regjistrim refuzohet;
të thërrasë çdo person të interesuar që të paraqitet tek ai ose te ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, për të dhënë informacion ose shpjegim për pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën;
t'i propozojë Kryeregjistruesit refuzimin e regjistrimit kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj;
të administrojë dhe të verifikojë të dhënat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij neni;
t'i kërkojë personit, që paraqet një informacion jo të rregullt, që t'ia paguajë zyrës së regjistrimit shpenzimet që ajo ka kryer në procesin e verifikimit të këtij informacioni jo të rregullt”.

Po kështu dhe vendosja e kufizimit, sipas nenit 59 të po këtij Ligji është kompetencë e Regjistruesit dhe e jo Kryeregjistruesit, pasi ky nen ka parashikuar se:

“Regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, me ose pa kërkesën e personit të interesuar. Ky shënim kryhet nga Regjistruesi për parandalimin e mashtrimit apo veprimeve të padrejta mbi të drejtat e pronësisë të regjistruara, kur nga faktet ose dokumentacioni i paraqitur/administruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme konstatohet se drejta e pronarit për të vepruar mbi pasurinë e paluajtshme është e kufizuar”.

Së dyti, regjistrimi apo vendosja e kufizimit sipas nenit 59, të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” janë akte administrative individuale që nxiren nga Regjistruesi dhe kundërshtimi i tyre nuk bëhet me ankesë nga subjekti i interesuar por sipas përcaktimeve ligjore të sanksionuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative. Në rastin konkret, nëse do kishte ankesë nga subjekti ndaj ZVRPP Berat, organi epror i tij, ish-ZQRPP, në raste të tilla kur bëhet ankimim ndaj mosveprimit të organit administrativ, do të duhej të ndërhynte duke zgjidhur çështjen përmes nxjerrjes së një akti administrativ përfundimtar.

K.Pr.Ad ka parashikuar në nenin 138, të tij se: “1. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ shqyrtohet drejtpërdrejtë nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë dosjen e çështjes dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative. 2. Organi epror, fillimisht, shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, vendos mbi kërkesën e palës, siç i është parashtruar organit kompetent.

3. Organi epror vendos mbi kërkesën në bazë të dosjes së çështjes apo, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime administrative shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë këto hetime shtesë dhe ta njoftojë për rezultatet e hetimit.

4. *Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, organi epror zgjidh çështjen duke nxjerrë një akt përfundimtar”.*

Në përmbushje të sa më sipër, ish-ZQRPP si organ epror i ZVRPP Berat nuk rezulton të ketë nxjerrë një akt të tillë administrativ, por shkresën me nr.6432/3 prot., datë 25.09.2018, e cila është një shkresë orientuese, ku ndër të tjera, orienton ZVRPP Berat të rishqyrtojë dokumentacionin dhe të regjistrojë si pronar subjektin “Stela” sh.p.k, duke mos e pajisur me dokument pronësie dhe duke vendosur kufizim sipas nenit 59 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe në përmbajtjen e kësaj shkrese ish-ZQRPP ka referuar si bazë ligjore nenet 20 dhe 59 të këtij Ligji.

Komisioneri, lidhur me sa më sipër, vlerëson se nenet sipërcituar janë pikërisht dispozitat ligjore të cilat parashikojnë kompetencat e Regjistruesisit dhe jo të Kryeregjistruesisit, dhe në këtë kontekst, lidhur me mosregjistrimin si pronar të subjektit “Stela” sh.p.k, ankuesja është në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të saj që i nje vetë ligji.

Së treti, nga këqyrja dhe administrimi i akteve shkresore të administruara gjatë procesit hetimor të ankesës së znj.C, rezulton se aktualisht çështja e objektit me kërkim regjistrimin dhe titullin e pronësisë së subjektit “Stela” sh.p.k ndodhet në proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, dhe në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ZVRPP Berat¹⁰ nuk mund të shprehej lidhur me këtë fakt. Nga ana tjetër, ZVRPP Berat në përgjigje të orientimit të ish-ZQRPP për të rishqyrtuar kërkesën e subjektit “Stela” sh.p.k ka referuar faktin që nga ana e këtij subjekti nuk është depozituar asnjë dokumentacion shtesë i ri, dhe në këto kushte, Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur dhe zbatuar nga ana e ZVRPP Berat është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore për trajtimin e këtij rasti dhe në përputhje të plotë me kompetencat ligjore të Regjistruesisit.

Nga ana tjetër, Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas verifikimit të ankesës së bërë nga subjekti “Stela” sh.p.k lidhur me praktikën e ndjekur nga ZVRPP Berat, nëpërmjet shkresës me nr.165/2 prot., datë 18.04.2017 i ka rekomanduar subjektit të ndjekë rrugën gjyqësore dhe nuk ka evidentuar asnjë shkelje nga ana e ZVRPP Berat.

Po ashtu, dhe Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet shkresës me nr.6975/2 prot., datë 29.12.2017, lidhur me këtë rast ka shprehur qëndrimin e vet se: *“ZVRPP Berat duhet të vijojë me trajtimin e kërkesës për regjistrim të subjektit “Stela” sh.p.k vetëm në rast aplikimi dhe depozitimi të dokumentacionit shtesë nga subjekti i interesuar dhe të ndjekë procesin gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat si palë e tretë, deri sa vendimi të marrë formë të prerë”.*

Pra, në kushtet kur subjekti “Stela” sh.p.k është në proces gjyqësor dhe ende nuk ka paraqitur dokumnetacion shtesë, ZVRPP Berat, nëpërmjet shkresës me nr.6432/3 prot., datë 25.09.2018, ka informuar subjektin se nuk mund të vijojë procedurat deri sa ai të paraqesë dokumentacion shtesë

¹⁰ Regjistruësja e ZVRPP Berat, në tagrin e përfaqësueses së kësaj Zyre.

dhe vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë, duke mos konsumuar asnjë lloj shkeljeje ligjore në këtë aspekt.

Së katërti, lidhur me referimin që bën Ministri i Drejtësisë në Urdhrin “Për lirimin nga detyra” të ankueses, tek shkresa me nr.2132 prot., datë 07.03.2019 e ish-Kryeregjistruesit përsa i takon mospërbushjes së detyrës, lidhur me mosregjistrimin e një numri aplikimesh brenda afateve ligjore, i cili ndër te tjera ka shërbyer si shkak për lirimin e saj nga detyra, Komisioneri vlerëson se, është në diskrecion të punëdhënësit, MD, vlerësimi i natyrës së shkeljes dhe llojit të masës disiplinore që aplikon. Pretendimet e ankueses për sa më sipër ezaurohen në rrugë gjyqësore dhe nuk përbëjnë objekt shqyrtimi të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së pesti, lidhur me referimin që bën Ministri i Drejtësisë në Urdhrin “Për lirimin nga detyra” të ankueses, tek shkresa me nr.2132 prot., datë 07.03.2019 e ish-Kryeregjistruesit përsa i takon shkeljes së rregullave të disiplinës dhe etikës nga punonjës të ZVRPP Berat (Shkresa citon se: *“Në datën 27.02.2019, Zëvendëskryeministri, në përmbushje të funksioneve të veta, ka zhvilluar një vizitë pune në qytetin e Beratit për të monitoruar cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike ndaj qytetarit dhe ka ushtruar verifikim pranë ZVRPP Berat, dhe nga konstatimet ka rezultuar se Regjistruesja B. C nuk ka qenë në fillimin e orarit zyrtar si dhe organizimi i punës dhe personelit nuk ishte në nivelet e kërkuara për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për qytetarët e Beratit. Një punonjëse e Zyrës, ishte me një veshje tërësisht të papërshtatshme...”*, për të cilat mban përgjegjësi ankuesja si titullare e ZVRPP Berat, Komisioneri vlerëson se, edhe kjo shkelje e cila ka shërbyer si shkak për largimin e ankueses është diskrecion i punëdhënësit. Pretendimet e ndryshme lidhur me procedurën dhe ligjshmërinë e saj zgjidhen gjyqësisht, sic dhe rezulton se ka ndodhur në rastin konkret, referuar Vendimit nr.898, datë 08.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Në përfundim të analizimit për sa më sipër, lidhur me tre shkeljet e konstatuara nga ana e punëdhënësit, MD, Komisioneri ka vlerësuar se lidhur me pikën e parë, praktika e ndjekur dhe zbatuar nga ana e ZVRPP Berat është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore për trajtimin e këtij rasti dhe në përputhje të plotë me kompetencat ligjore të Regjistruesit. Nga ana e MD nuk u sollën prova apo argumenete që të provonin të kundërtën. Ndërsa lidhur me dy pikat e tjera, Komisioneri ka vlerësuar se nuk është kompetencë e tij të shprehet lidhur me ligjshmërinë apo jo të tyre.

Përsa i takon procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masës disiplinore të lirit nga detyra të ankueses, Komisioneri gjykon se, nga ana e MD nuk u sollën prova dhe dokumentacion që të mund të provonin apo përligjinin faktin se punëdhënësi, MD, kishte ndjekur dhe zbatuar procedurën e rregullt ligjore lidhur me njoftimin e masës, të drejtën e ankueses për t’u dëgjuar dhe mbrojtur efektivisht.

Dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore

duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t'i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës, si dhe për faktin se masat disiplinore më të lehta parashkruhen me kalimin e afateve të caktuara ligjore.

Nëse procedura e njoftimit apo e masës disiplinore do të respektohet, atëherë pa diskutim që punëdhënësi ka të drejtë ta përshkallëzojë dhënien e masës deri në ekstremin e saj. Në të kundërt, nëse punëdhënësi nuk e provon këtë gjë, atëherë ai mund të abuzojë me preteksin e shkeljes së disiplinës për të pushuar nga puna çdo punëmarrës.

Komisioneri gjykon se nga ana e MD është shkelur e drejta e ankueses për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur efektivisht ndaj shkeljeve të konstatuara në shkresën nr.2132 prot., datë 07.03.2019 të ish-Kryeregjistruesit, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm, i paligjshëm dhe i padrejtë nga ana e MD.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Ministria e Drejtësisë jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv dhe të justifikueshëm, por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Lidhur me diskrecionin e Ministrit të Drejtësisë për emërimin dhe shkarkimin e regjistruesve të ZVRPP-ve, bazuar në ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Komisioneri vlerëson se:

- Neni 13, pika e) e ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ka përcaktuar se, një ndër kompetencat e Ministrit të Drejtësisë është dhe emërimi i regjistruesve të ZVRPP-ve¹¹.
- Neni 19/2 i po këtij Ligji, ka përcaktuar gjithashtu dhe kompetencën e Ministrit të Drejtësisë për shkarkimin e tyre¹², pas propozimit të Kryeregjistruesit.

¹¹ Ministri i Drejtësisë, në zbatim të këtij ligji, ushtron këto kompetenca:

- a) propozon politikat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- b) propozon pranë Këshillit të Ministrave projektbuxhetin vjetor të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- c) miraton, me udhëzim të përbashkët me Ministrin e Financave, tarifat e shërbimit dhe të veprimeve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- ç) i propozon Këshillit të Ministrave emërimin e Kryetarit të Bordit Drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- d) emëron dy anëtarë të Bordit Drejtues, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.
- dh) i propozon Kryeministrit emërimin dhe shkarkimin e Kryeregjistruesit;
- e) emëron regjistruesit e zyra ve të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

- “Diskrecioni” nuk është arbitraritet, por duhet të ushtrohet brenda vlerësimit të autoriteteve dhe rregullave të arsyes dhe drejtësisë. Pra, vendimi i ndërmarrë nuk duhet të jetë arbitrar por i drejtë dhe ligjor, si dhe të ushtrohet brenda kufijve për realizimin e një qëllimi të ligjshëm dhe në zbatim të akteve ligjore.
- Vërtet Urdhri i Ministrit të MD është një akt administrativ me natyrë diskreciale dhe vjen pas propozimit të bërë nga Kryeregjistruesi, por në rastin konkret është i paligjshëm, pasi nuk ka ndjekur dhe respektuar procedurën e rregullt ligjore për lirimimin e ankueses nga detyra, duke cënuar të drejtën e saj për t’u dëgjuar dhe mbrojtur efektivisht përpara punëdhënësit.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e punëdhënësit, MD.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹³, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për cilindo nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Në ankesën fillestare, regjistruar pranë KMD me nr. 86 regj., datë 30.07.2020 dhe plotësuar me shkresën me nr.1119/2 prot., datë 19.08.2020, ankuesja ka pretenduar si shkaqe diskriminimi: “gjininë”, “përkatësinë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në vijim, nëpërmjet e-mailit të datës 30.10.2020 ankuesja ka parashtruar kërkesën që KMD të shprehet vetëm për shkakun e cilësuar si “çdo shkak tjetër”, me shpjegimin se është liruar nga detyra pikërisht për shkak të mosregjistrimit si pronar të subjektit “Stela” sh.p.k nga ZVRPP Berat, sipas orientimeve të kundraligjshme të ish-Kryeregjistruesit.

¹² Neni 19/2 po aty, përcakton se: *“Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme organizohet dhe drejtohet nga regjistruesi, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Kryeregjistruesit”.*

¹³ *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”*

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

B/I “Çdo shkak tjetër”

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹⁴.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹⁵.

Në çështjen në shqyrtim, shkaku i pretenduar nga ankuesja nuk është një shkak që parashikohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë si shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminim”. Në mënyrë që ankuesja të provojë diskriminim për shkakun e pretenduar, duhet të provohet se ajo gëzon ndonjë “shkak tjetër”, në kuptim të nenit 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminim”.

Për të vlerësuar nëse shkaku i pretenduar gëzon mbrojtje nga cilësimi “për çdo shkak tjetër”, Komisioneri, në mungesë të një praktike kombëtare, do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut¹⁶, në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statusëve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut¹⁷.

Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

¹⁴ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

¹⁵ Neni 14, I KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*

¹⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën GJEDNJ.

¹⁷ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KEDNJ.

Bazuar në nenin 9/2 të Kodit të Punës mbrojtja nga diskriminimi garantohet bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar se: *“Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”*

Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se lirimi i saj nga detyra është motivuar nga konflikti i krijuar për shkak të moszbatimit të urdhrin të kundraligjshëm të eprorit të saj direkt, nuk qëndron, pasi:

- Në Urdhrin nr.201, datë 13.03.2019 “Për lirim nga detyra”, të Ministrit të Drejtësisë, përveç sa më sipër, janë konstatuar edhe dy shkelje të tjera. Pra, mosregjistrimi si pronar të subjektit “Stela” sh.p.k nga ana e ZVRPP Berat, nuk ka qenë motivi i vetëm për largimin e saj nga detyra.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

- Referuar citimit sa më lart, Komisioneri nuk ka evidentuar një karakteristikë personale ose të identifikueshme të ankueses e cila, në përputhje me rrethanat e çështjes të kishte shërbyer si shkak për trajtimin e saj të paligjshëm nga ana e punëdhënësit.

Konfliktin e krijuar mes ankueses dhe ish-Kryeregjistruesit, eprorit direkt të saj, për shkak të detyrës si Regjistruese e ZVRPP Berat, lidhur me mosregjistrimin dhe dhënien e titullit të pronësisë për subjektin “Stela” sh.p.k nga ZVRPP Berat; Komisioneri nuk e cilëson si shkak të mbrojtur të LMD-së, referuar si “çdo shkak tjetër” dhe vlerëson se ankuesja nuk e mbart këtë shkak.

Pra, sikundër citohet më lart, konfliktin e prezumuar ankuesja e kishte me eprorin direkt, i cili bazuar në kompetencat e tij si Kryeregjistrues kishte vetëm të drejtën e propozimit të masës, ndërsa theksojmë se vendimmarrës është punëdhënësi, MD, në këtë rast. Për rrjedhojë, konflikti mes ankueses dhe eprorit direkt të saj, nuk mund të ketë shërbyer si shkak diskriminues, për sa kohë për lirim nga detyra ka vendosur një organ tjetër i cili është vendimmarrës, pra punëdhënësi i saj, MD, dhe që nuk ishte i përfshirë në këtë konflikt.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁸, Komisioneri vlerëson se znj.C i është nënshtruar një qëndrimi të paligjshëm e të padrejtë nga ana e MD:

- lidhur me pikën e parë të cituar në Urdhrin e saj të lirimimit nga detyra, përse i takon mosregjistrimit si pronar të subjektit “Stela” sh.p.k,
- si dhe përse i takon mosrespektimit të procedurës së rregullt ligjore për dhënien e masës disiplinore ekstreme nga ana e punëdhënësit ndaj saj.
- MD, lidhur me lirimimin nga detyra të ankueses, nuk arriti të provojë se kishte respektuar të drejtën e ankueses për t’u mbrojtur efektivisht në lidhje me shkeljet e pretenduara, në përputhje me frymën dhe parashikimet ligjore të K.Pr.Ad

Nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk arriti të provojë dhe dokumentojë se shkak i pretenduar prej saj plotëson kriteret e “shkakut” të mbrojtur sipas LMD.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se subjekti ankues i është nënshtruar trajtimit të padrejtë e të paligjshëm nga ana e MD, lidhur me pikat sipër cituar, nuk u arrit të provohej se lirimi i saj nga detyra ishte motivuar për një shkak të ligjshëm, të mbrojtur nga LMD.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, B. C, nga Ministria e Drejtësisë, për shkakun e pretenduar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

¹⁸ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Fusha: Punësim

Shkaku: Çdo shkak tjetër (konflikti me eprorin)

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim